



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 2245 Prot.

Tiranë, më 12.03. 2020

NJOFTIM

Në kuadër të planit të masave të ndërmarra për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19, marrë shkas edhe nga situata në të cilën ndodhet vendi ynë, Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, njofton të gjithë autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, si më poshtë vijon:

1. Autoritetet kontraktore të pezullojnë shpalljen e procedurave të reja prokurimi, për një afat 15 ditor, duke filluar nga dita e sotme, datë 12.03.2020.
2. Për procedurat e prokurimit që janë në proces, pra ato që janë të shpallura nga autoritetet kontraktore apo janë në proces vlerësimi, të shtyhen si afati i dorëzimit të ofertave ashtu dhe afati i vlerësimit të tyre me 15 ditë, duke nisur nga dita e sotme, datë 12.03.2020.
3. Autoritetet kontraktore të pezullojnë zbatimin e kontratave të nënshkruara për mallra, punë, shërbime, për një afat 15 ditor, duke nisur nga dita e sotme, datë 12.03.2020.

Bëjnë përfjashtim nga zbatimi i këtij Njoftimi procedurat e prokurimit që vlerësohen si emergjente apo të domosdoshme nga autoritetet kontraktore, si dhe zbatimi i kontratave që vlerësohen të domosdoshme për shkak të objektit të tyre, të cilat mund të vijojnë normalisht, për sa është e mundur.

Gjithashtu, në rast se autoritetet kontraktor vlerësojnë se, procedurat e prokurimit të shpallura janë të domosdoshme për të mbuluar nevojat e tyre në situatën e krijuar, atëherë mund të vazhdojnë, për sa është e mundur hapjen dhe vlerësimin e ofertave, pa qenë e nevojshme të shtyjnë afatin, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij Njoftimi.

Duke ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

